



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më

Nr.

prot.

Data: 11.3.2025

Nr: 258

Ora: 12:00

VENDIM
PËR
SHQYRTIMIN E RAPORTIT MBI VEPRIMTARITË PUBLIKE PËR PERIUdhËN 2
MARS- 8 MARS 2025

Sot, më datë 11.3.2025, unë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mora në shqyrtim çështjen administrative me:

OBJEKT: Shqyrtimi i raportit mbi veprimtaritë me karakter publik të disa institucioneve për periudhën 2 mars deri më 8 mars 2025.

BAZA LIGJORE: Nenet 19 pika 1, shkronja “n”, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar.

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

V E N D O S:

1. Miratimin e raportit të gjetjeve mbi veprimtaritë publike për periudhën 2 mars deri më 8 mars 2025, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim i njoftohet palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Tiranë më	
Nr.	prot.

RAPORTI I GJETJEVE

MBI

VEPRIMTARITË ME KARAKTER PUBLIK TË DISA INSTITUCIONEVE, PËR PERIUdhËN 2 MARS-8 MARS 2025

Në lidhje me raportimet e veprimtarive publike në Ndërfaqen e Raportimeve të Institucioneve (NRI), për periudhën 2 mars-8 mars 2025, konstatohet si vijon:

- 8 institucione publike të reja janë regjistruar gjatë kësaj periudhe në NRI, dhe kanë akses për raportimin e veprimtarive,
- **361 raportime** janë kryer **në total**,
- 353 postime janë aktive,
- **8 veprimtari janë të ndaluar automatikisht** për shkak të afatit të raportimit.

Për datat **2 mars–8 mars 2025**, në ndërfaqen e raportimeve janë ndaluar automatikisht 8 veprimtari të raportuara nga 7 institucione, për shkak të tejkalimit të afatit ligjor.

1. Prefekti i Qarkut Fier ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari jashtë afatit të përcaktuar në nenin 92, pika 2, e Kodit Zgjedhor, me tematikë si më poshtë vijon:

- "Prefekti i Qarkut Fier do të zhvillojë një takim festiv me rastin e festës së mësuesit, më datë 7 mars, ora 18:00-19:00", nderojmë dhe vlerësojmë figurën e mësuesit", në sallën e teatrit Bylis Fier. Janë të ftuar: Zv. Kryeministri zj. Belinda Balluku, Ministrja e Arsimit Ogerta Manastirliu, Kryetarët e Bashkive të Qarkut Fier, Drejtoria Arsimore Rajonale Fier, ZVA-të e Qarkut Fier, mësues veteranë, etj, raportuar në datë 3.3.2025 për t'u zhvilluar në datë 7.3.2025.

Personi përgjegjës për raportimet pranë këtij Institucioni ka njoftuar nëpërmjet postës elektronike si vijon: *Gjatë hedhjes së të dhënave në ditën e sotme kam kryer një gabim teknik në llogaritjen e ditëve, dhe të orës, lidhur me aktivitetin me tematikë për 7 Marsin, ditën e mësuesit, ku dhe do të ndahen dhe vlerësimet. Aktiviteti do të organizohet nga Prefekti i Qarkut Fier, më datë 7 Mars, ora 11 00, në sallën e Teatrit Bylis Fier, me pjesëmarrjen e Zv. Kryeministres, Ministres së Arsimit, Kryetarëve të Bashkive, mësuesve veteranë etj. Kemi llogaritur ditën e raportimit nga momenti i hedhjes së të dhënave. Gjithashtu, kemi pritur edhe konfirmimin e pjesëmarrjes së personaliteteve të sipërpërmendura. Në këto kushte nuk kemi pasur mundësi për ta kryer më parë raportimin. Ju kërkujmë mirëkuptimin e situatës dhe të mos konsiderohemi në shkelje”.*

Për sa më sipër, pasi u njoha me arsyet e paraqitura nga ana e personit përgjegjës për raportimet, vlerësohet se është një gabim njerëzor gjatë hedhjes së të dhënave dhe llogaritjes së ditëve. Në këto kushte mirëkuptohet situata dhe vlerësohet se nuk jemi para shkeljes administrative.

2. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Librazhd ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari me tematikë si më poshtë vijon:

- "Festa e 7 Marsit, dita e mësuesit", raportuar në datë 3.3.2025 për t'u zhvilluar në datë 5.3.2025.

Nga verifikimet e kryera në faqen e ZVAP Librazhd në rrjetet sociale rezulton një postim i datës 8 mars, ora 18:00, në ambientet e Piceri Sopotit, me të njëjtët pjesëmarrës të deklaruar në raportimin përkatës, ku është kryer një aktivitet/mbrëmje me rastin e festave, me prezencën e disa arsimtarëve, të cilëve, u është dhuruar nga një certifikatë mirënjohje për punën e tyre, nga Ministria e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, zj. Bora Muzhaqi. Kjo veprimtari është raportuar në NRI nga Ministria përkatëse dhe Bashkia Librazhd, sipas afatit ligjor të raportimit, në datë 8 mars 2025 ora 18:00 pranë Piceri Sopotit.

Personi përgjegjës për raportimet pranë këtij Institucioni ka njoftuar nëpërmjet postës elektronike si vijon: *“Në lidhje me raportimin që kemi bërë për datën 5 mars, ju bëj me dije se ky raportim është bërë gabimisht kur kemi plotësuar të dhënave dhe data e saktë është 8 mars, e jo 5 mars 2025”.*

Përsa më sipër, vlerësojmë se jemi para një gabimi në hedhjen e datës së aktivitetit. Në këto kushte mirëkuptohet situata dhe vlerësohet se nuk jemi para shkeljes administrative.

3. Bashkia Malësi e Madhe ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari jashtë afatit të përcaktuar në nenin 92, pika 2, e Kodit Zgjedhor, me tematikë, si më poshtë vijon:

- “Aktivitet me mësuesit”, raportuar më datë 3.3.2025 për t'u zhvilluar më datë 7.3.2025

Nga verifikimet e kryera në faqen e Bashkisë Malësi e Madhe rezulton se është kryer një aktivitet me rastin e festave të 7-8 marsit, me prezencën e disa mësuesve, të cilëve u është dhuruar lule dhe nga një certifikatë mirënjohje për punën e tyre dhe është mbajtur dhe një festë e vogël për ta.

Përsa më sipër, vlerësohet se për shkak të tematikës së aktivitetit, nuk mbart detyrim për raportim.

4. Bashkia Elbasan ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 2 (dy) veprimtari jashtë afatit të përcaktuar në nenin 92, pika 2, e Kodit Zgjedhor, me tematikë si më poshtë vijon:

- “Inspektim i përfundimit të punimeve në gjimnazin "Kostandin Kristoforidhi", si edhe duke bërë urimin përkatës mësuesve për ditën e "7 Marsit", raportuar në datë 3.3.2025 për t'u zhvilluar në datë 7.3.2025.
- Në kuadër të festimeve të "Ditës së Verës organizohet aktiviteti kulturor me fëmijët e kopshteve të qytetit të Elbasanit me emërtesën "trashëgimia në duart e vogla", raportuar në datë 5.3.2025 për t'u zhvilluar në datë 9.3.2025.

Personi përgjegjës për raportimet ka njoftuar nëpërmjet postës elektronike se: *“Aktiviteti i parë, i cili ishte raportuar më datë 3.3.2025, për t’u zhvilluar më datë 7.3.2025, është anuluar”.*

Për sa më sipër, pasi u verifikuan faktet e paraqitura nga ana e personit përgjegjës për raportimet, vlerësohet se për veprimtarinë e parë, në kushtet kur nuk është zhvilluar, nuk jemi para kundërvajtjes administrative.

Referuar rrethanave, fakteve të raportuara në ndërfaqe dhe tematikës së aktivitetit të dytë, pasi u verifikuan dhe postimet në faqen e Bashkisë Elbasan, vlerësohet se veprimtaria e raportuar jashtë afatit “Aktivitet kulturor me fëmijët e kopshteve të qytetit të Elbasanit”, nuk përbën veprimtari institucionale publike që mbart detyrim për raportim, pasi s’është aktivitet i Bashkisë, por pjesë e organizimeve për ditën e verës, që mbahen në Qytetin e Elbasanit dhe Bashkia mirëpret të gjithë organizatorët/pjesëmarrësit në këtë festë të përvitshme.

5. Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari jashtë afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2, e Kodit Zgjedhor, me tematikë si më poshtë vijon:

- "Në datat 5-7 mars 2025, Banka Botërore me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit dhe Komisionin e Prokurimit Publik si bashkëorganizator, zhvillojnë workshopin “New EGP System with AI in Albania”. Aktiviteti ka qellim për të trajnuar stafin teknik”, raportuar në datë 4.3.2025 për t’u zhvilluar në datën 5.3.2025

Në shënimet përkatëse kanë sqaruar se: *Raportimi nuk mund të bëhej me herët, sepse më datë 3 Mars ka ardhur konfirmimi për realizimin e aktivitetit nga ekspertët e KE-së dhe të Open Contracting Partnership.*

Njëkohësisht aktiviteti është raportuar nga Komisioni i Prokurimit Publik në përputhje me afatet ligjore të parashikuara në Kodin Zgjedhor.

Për sa më sipër, pasi u njoha me sqarimet e paraqitura, vlerësohet se në kushtet kur ndodhemi para pamundësisë për të raportuar brenda afateve ligjore, shpeshherë për shkaqe që nuk varen nga ana e institucioneve raportuese, mirëkuptohet situata dhe pamundësia për të raportuar brenda afatit.

6. Bashkia Vlorë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari jashtë afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2, e Kodit Zgjedhor, me tematikë si më poshtë:

- Një Festë me Zemër për Ata që Japin Shumë! "Me Zemër për Mësuesit dhe Gratë e Qytetit"-Festimet e 7 dhe 8 Marsit në Vlorë. Në shenjë mirënjohjeje dhe respekti për figurën e mësuesit dhe rolin e gruas në shoqëri, Bashkia Vlorë organizon një ceremoni” raportuar në datë 5.3.2025, për t’u zhvilluar në datë 6.3.2025.

Nga verifikimet e kryera në faqen e Bashkisë Vlorë rezulton se nuk ka aktivitete të kryera në këtë datë, postimi i radhës që ka lidhje me tematikën në fjalë është një urim dhe një lule, që ju jepet në mënyrë rastësore grave dhe vajzave në rrugët e Qytetit të Vlorës, nga Policët Bashkiakë.

Përsa më sipër, vlerësohet se ky aktivitet nuk përbën veprimtari institucionale publike, që mbart detyrim për raportim,

7. Bashkia Dropull ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari jashtë afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 e Kodit Zgjedhor, me tematikë si më poshtë:

- “Takim me mësuesit pensionistë me rastin e festës të 7 Marsit”, raportuar në datë 7.3.2025 për tu zhvilluar në datë 11.3.2025.

Nga verifikimi në ndërfaqen e raportimeve, rezulton se Bashkia Dropull e ka riraportuar veprimtarinë më datë 7.3.2025 për t’u zhvilluar më datë 13.3.2025, në përputhje me afatet ligjore të raportimi. Në këto kushte nuk jemi para kundërvajtjes administrative.

KQZ është në monitorim të vazhdueshëm të këtij procesi dhe në vijimësi do duhet që të gjithë institucionet shtetërore të kryejnë raportimet në lidhje me veprimtaritë që planifikohen të zhvillohen prej tyre, të paktën 5 ditë para zhvillimit të tyre dhe në përputhje me dispozitat e Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9/2020, të Komisionit Rregullator, të ndryshuar.